



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1862, datë 10.04.2012

Për

“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD 1730, datë 20.12.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Albtelecom sh.a.””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.04.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbyllja e procedimit administrativ të filluar me VKD 1730, datë 20.12.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Albtelecom sh.a.”

të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (***Raporti***);
- Projekt Vendim i KD (***Projekt Akti***);
- Dokumentet shkresore të palëve (***Provat, Pretendimet***);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

K Ë SHILL I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendimi nr. 1730, datë 20.12.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Altelecom sh.a.”;
- Shkresën e AMC sh.a., me nr. 4213/5, datë 4.1.2012 (nr. 1709/2Prot. i AKEP, datë 4.1.2012) “*Pretendimet e shoqërisë AMC për ankimin administrativ kundër operatorit Altelecom për tarifën e terminimit mes rrjetave fiks të AMC dhe Altelecom*”.

diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. AKEP me anë të Vendimit nr. 1730, datë 20.12.2011, të Këshillit Drejtues “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Altelecom sh.a.”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:
 - “*Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Altelecom sh.a.*;
 - *Të njoftohen palët e interesuara Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Altelecom sh.a për fillimin e procedimit administrativ;*

- *Palët të depozitohen pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit*”;

II. AMC me shkresën nr. 4213/5, datë 4.1.2012, ka sjellë pretendimet në lidhje me këtë procedim administrativ ku sqaron si më poshtë:

1. AMC, pasi është regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që kanë njoftuar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm dhe pasi është pajisur me Autorizim Individual, ka kërkuar akses dhe interkoneksion tek të gjithë operatorët e telefonisë fikse dhe mobile në mënyrë që shërbimi i ri t'i ofrohej publikut sa me shpejt të ishte e mundur.
2. Me të gjithë operatorët e tjerë të cilët janë lidhur direkt me AMC si edhe me operatorët mobile negocimi i tarifave të terminimit, kontrata e interkoneksionit per AMC FIX, lidhja fizike e interkoneksionit, testet teknike dhe hapja e shërbimit të interkoneksionit janë bërë brenda afateve të parashikuara në ligj dhe rregullore.
3. Me Albtelecom sh.a., ky proces u vonua për shkak të mosmarrëveshjes së terminimit në rrjetin e AMC FIX dhe të Albtelecom. AMC në negociatat me Albtelecom si dhe me të gjithë operatorët e tjerë u udhëhoq nga parimi i simetrisë për tarifën e terminimit midis dy operatorëve të telefonisë fikse.
4. Më datë 27.5.2011, me e-mail, AMC ka njoftuar Albtelecom për ofrimin e shërbimit publik të telefonisë fikse. Me shkresën nr. 1401/6, datë 1.7.2011, AMC ka njoftuar Albtelecom për tarifën e terminimit në rrjetin fikse të AMC, si për trafikun kombëtar ashtu edhe për atë ndërkombëtar. Duke ndjekur parimin e simetrisë: Albtelecom tarifon AMC me 3.5 lekë/min dhe 0.83 lekë/thirrje, AMC njoftoi se do ta tarifonte me të njëjtën tarifë.
5. Albtelecom, përgjigjet me shkresën nr. 1401/6A, datë 15.7.2011, se i ka përfshirë tarifën në draft marrëveshjen e interkoneksionit sipas parimit të reciprocitetit i dërguar më 6.7.2011. Ky draft përmbante tarifën simetrike për terminimet në rrjetat fikse të Albtelecom dhe AMC prej 3.5 lekë/min dhe 0.83 lekë/thirrje.
6. Albtelecom më datë 4.8.2011, me e-mail, ku prezantohet fakti që tarifën e pajtimtarit të Albtelecom drejt rrjeteve të tjerave fikse janë të rregulluara me vendimet e AKEP nr. 1348 dhe 1368, ku vlera maksimale e lejuar e tarifës retail të Albtelecom është 2.5-3 lek.minute për familjare dhe 2.6-3.9 lek/minute per Të Tjerë.
AMC u detyrua të pranonte tarifën e terminimit 1.5 lekë/min në rrjetin e saj dhe të paguante 1.5, 2.5 dhe 3.5 lekë/min për terminim në rrjetin e Albtelecom.
7. Në vendimin nr. 1348, për shpalljen e Albtelecom OFNT, thuhet: “...(4) *Për thirrjet jashtë rrjetit Albtelecom, në rast të rritjes së detyrimit të Albtelecom për palët e treta (përfshirë tarifa më të larta të një pale të tretë nga operatorët aktuale, Albtelecom ka të drejtë të aplikojë tarifa më të larta nga ato të tabelës së mësipërme, por jo më të larta se shumica e detyrimit për palët e treta dhe pjesës së mbajtur të Albtelecom (Pjesa e mbajtur e propozuar nga Albtelcom me shkresën nr. Prot.709, datë 08.02.2010, dhe miratuar nga AKEP me Vendimin nr. 1182, datë 10.03.2010). Për këto raste Albtelecom ka detyrimin e*

njoftimit të AKEP të paktën 15 ditë kalendarike përpara aplikimit të tarifës së re dhe i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që verteton rritjen e detyrimit të Altelecom..”

8. AMC kërkoi nga Altelecom ndryshimin e tarifës 1.5 lekë/min në tre nivele në mënyrë që të plotësohej parimi i simetrisë. Altelecom u përgjigj se kjo pikë është e aplikueshme në rast se operatori, palë e tretë, është lehtësisht i dallueshëm nga pajtimtari dhe pajtimtari do të mund të ishte i vetëdijshëm që po thërret drejt një rrjeti tjetër me tarifë më të lartë. Psh. Në rastin e thirrjeve drejt Plus Communications, ku tarifa e terminimit është më shumë se dy herë më e lartë se tek AMC, Vodafone apo Eagle. Kjo është një nga arsyet që në rastin e numrave të portuar, është futur “beep” në mënyrë që pajtimtari të jetë i vetëdijshëm se po thërret drejt një rrjeti tjetër me tarifë më të lartë retail. Në rastin e shërbimeve lokale fikse kjo është e pamundur, pasi pajtimtarit do t’i duhej të identifikonte një nga një të gjithë numrat e operatorëve të tjerë në zonën lokale përkatëse dhe Altelecom me të gjithë operatorët e tjerë ka aplikuar të njëjtën tarifë. Për më tepër, arranzhimet që kemi përfshirë në marrëveshjen e arritur janë të natyrës tranzitore dhe siç kemi rënë dakord do jenë objekt i rikonsiderimit të AKEP.
9. AMC ka dërguar shkresat zyrtare drejt AKEP nr. 4213 dhe 4213/1 prot, datë 2.9.2011 dhe trajton problemin e tarifës së terminimit për trafikun fiks-fiks mes Altelecom dhe AMC.

AMC kërkoi takim në AKEP për të diskutuar mbi këtë çështje dhe për të vënë në lëvizje AKEP në përmbushje të detyrimeve që organi rregullator ka në fushën e interkoneksionit. AKEP organizoi një takim dypalësh midis AMC dhe Altelecom, por sipas AMC nuk u arrit në një përfundim në lidhje me çështjen në fjalë.
10. AMC e nënshkroi MI me Altelecom në kushtet kur nuk kishte asnjë zgjidhje tjetër për të zhbllokuar situatën, ndërkohë që Altelecom mbajti një qëndrim që në vlerësimin tonë është në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi dhe me shpalljen e Altelecom si OFNT.
11. Gjatë negociimit të tejzgjatur të kësaj çështje AMC u përpoq të aplikojë një koncept simetrie duke rënë dakord me operatorët fiks në lidhje me tarifën. Altelecom, në mënyrë të qëllimshme për të vonuar fillimin e shërbimit të ri nga ana e AMC, pasi ra dakord në muajin Korrik, më pas ndryshoi qëndrim duke e justifikuar me rregullimin e tarifave tij të terminimit dhe të shërbimeve me pakicë. AMC i ka kërkuar Altelecom të orientohen drejt një tarife të barabartë dhe më pas të aplikojë një tarifë të parregulluar, apo të rrisë tarifën e tij të pakicës. (AMC ka sugjeruar tarifën 5 lekë) Gjithashtu, i bëri me dije Altelecom se AMC mund të implementojë terminimin lokal të thirrjeve, dhe për pasojë simetrinë, në zonat jashtë Tiranës, por me kosto rreth 460 mijë euro për pikat lokale dhe po të njëjtën vlerë për pikat e bashkive, që sipas llogaritjeve tona është e nevojshme.
12. Bazuar në vendimin e AKEP për shpalljen OFNT të Altelecom, kishte mundësi të shtojë një marzh fitimi në tarifën e terminimit, që ne si jo-FNT në këtë segment të tregut mund t’ia tarifojmë.
13. AMC propozoi dy alternativa: (1) tarifa simetrike në nivelin 1.5, 2.5 dhe 3.5 lekë/min plus tarifën fillestare të thirrjes në varësi të vendndodhjes (lokale rajonale apo nacionale), (2) tarifën jashtë Tiranës të ish-in simetrike në nivelin 3.5 lekë/min plus tarifën fillestare të

thirrjes. Më pas Albtelecom mund të shtojë shumën e rezervuar për ata si marzh fitimi, të aprovuar nga AKEP në vendimin nr. 1182, datë 10.3.2010.

14. Albtelecom nuk ka pranuar asnjërën nga alternativat e propozuara. AMC, e ka hedhur në treg produktin e telefonisë fikse dhe se ky produkt mund të ofrohet në kushte më të mira për përdoruesin, ripërsërisim kërkesën tonë që AKEP të sqarojë dhe interpretojë qartësisht mënyrën se si mund të implementohen tarifat simetrike sa më gjerësisht. Në mënyrë alternative kjo çështje mund të sqarohet në kuadër të implementimit të metodologjisë BULRAIC të rregullimit të tarifave të Albtelecom, por mundësisht një kohës sa më të shpejtë.
15. Së fundmi, AMC bazuar në nenet 7, 8, 13, 15, 20, 39, 47, 49, 51, 60 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën Shqipërisë”, kërkon që AKEP: Të konstatojë që qëndrimi i Albtelecom nuk është në përputhje me dokumentat rregullatore për shpalljen e Albtelecom si OFNT (VKD nr. 1348) dhe të urdhërojë ndryshimin e pjesës përkatëse të MI sipas kërimit të AMC më lart, duke detyruar operatorin Albtelecom të ofrojë një tarifë terminimi për trafikun e terminuar në rrjetin e tij në përputhje me kërkimin e mësipërm të shoqërisë.

III. Albtelecom me shkresën nr. 496Prot., datë 30.1.2012, “*Depozitimi i pretendimeve përfundimtare të Albtelecom, në zbatim të vendimit nr. 1730, datë 23.12.2011*”, ka sjellë pretendimet si më poshtë:

1. AMC ka njoftuar për implementimin e numeracionit fiks të AMC, dhe ka kërkuar nënshkrimin e amendamentit përkatës. Në këtë amendament mungonte elementi thelbësor i çdo kontrate, tarifa. Një muaj më vonë, AMC ka njoftuar Albtelecom për tarifat e terminimit në vlerat 4.33 lekë/min për trafikun kombëtar dhe 6.5 lekë/min për trafikun ndërkombëtar, ndryshe nga ç’ka cituar AMC në shkresën drejtuar AKEP, për tarifat e ofruara nga AMC bazuar në parimin e simetrisë prej 3.5 lekë dhe 0.83 lekë/thirrje. Në asnjë moment të kësaj shkrese apo korrespondence elektronike nuk është përmendur parimi i simetrisë dhe duket se AMC akoma nuk e pranon kuptimin e saktë të këtij parimi.
2. Albtelecom i ka thyer përgjigje AMC me shkresën nr. 3279Prot, datë 14.7.2011, ku e informon për të gjitha veprimet e ndërmarra nga Albtelecom për implementimin e shërbimit Fix AMC, konfigurimet në centrale, testet në data të caktuara, dhe i ka ofruar të gjithë mbështetjen për të finalizuar sa më shpejt ofrimin e këtij shërbimi.
3. Albtelecom në përgjigje të tarifave të ofruara nga AMC, prej 4.33 lekë/min dhe 6.5 lekë/min, ka deklaruar se tarifat e këtij shërbimi do të jenë sipas parimit të reciprocitetit në analogji me nivelin e tarifave të Albtelecom.
4. Ky parim, referuar edhe parimeve të interkoneksionit, parimeve rregullatore teknike, do të thotë niveli i njëjtë tarife për të njëjtin nivel interkoneksioni në hierarkinë e rrjetit. Struktura e rrjetit të Albtelecom, njihet dhe kjo ka imponuar terminim në segmente të trafikut dhe imponimin për interkonektimin në nivele të ndryshme të hierarkisë së centraleve për të shkëmbyer trafik mes palëve të interkonektuara në një zonë të caktuar. Edhe vetë AKEP në dokumentet rregullatore është shprehur se

- terminimi në rrjetin e Albtelecom do të jetë sipas segmenteve të terminimit në varësi të nivelit të interkonektimit të operatorit.
5. Nëse AMC kërkon të përfitojë tarifë lokale terminimi në rrjetin e Albtelecom (AT) do të duhet të lidhet lokalisht me centralet lokale të Albtelecom, dhe e kundërta në se do të interkonktohej lokalisht në 12 zonat rajonale të AT, duke siguruar vetë rrugëzimin e trafikut deri në këto pika.
 6. AT terminon në rrjetin e AMC me 1.5 lekë/min, por në të njëjtën kohë kryen mbledhjen dhe rrugëzimin e të gjithë trafikut dhe ja dorëzon AMC në një pikë të vetme interkoneksioni dhe të gjitha këto ia ofron falas.
 7. Sipas RIO të AT për ofrimin e shërbimeve të interkoneksionit dhe interkoneksioni me operatorët është i shpjeguar me detaje, centralet ku ofrohet interkoneksionit, segmentet e terminimit, ndarja e zonave, pikat e Interkoneksionit si dhe cdo teknikalitet i nevojshëm në këtë rast. AT si operator me FNT nuk mund t'i ofrojë AMC në asnjë rast shërbime me kushte dhe terma të ndryshëm nga ata të publikuar dhe që i ofron aktualisht për të gjithë operatorët me të cilët është i interkonektuar.
 8. AMC po përdor në mënyrë të padrejtë një lapsus të AT për tarifën e përfshirë në draftin e marrëveshjes së interkoneksionit të dërguar nga ana jonë, e cila nuk është detyruese, e nuk mund të keqpërdoret nga AMC.
 9. AT sqaron në lidhje me tarifat e abonentit, se parimi i orinetimit të tarifave në kosto nuk i lejon që të rrisin artificialisht tarifën e abonentit për të kënaqur kërkesën e AMC për rritjen e tarifës së interkoneksionit thjesht për të rritur fitimin e AMC. Kjo do të çonte në dyfishimin e tarifës së abonentit drejt rrjetit Fix të AMC dhe nuk kuptojme se si kjo do të shërbente, ashtu siç shprehet AMC, në favor të konsumatorit. Shërbimi i AMC fix nuk është kaq lehtësisht i identifikueshëm për pajtimtarin, në mënyrë që ai të jetë koshient për thirrjet drejt një rrjeti me tarifë dyfish më të lartë, kështu që edhe në këtë rast AT beson se cdo rritje tarife e interkoneksionit apo abonentit do të shkonte vetëm në disfavor, madje në dëm të pajtimtarit.
 10. Megjithëse AMC ka marrë shkas nga AKEP në lidhje me këtë rast me citimin e pikës 4 të Vendimit të OFNT të AT, është prapë vetë AKEP i cili në takimin që u mbajt për këtë qëllim nuk favorizoi rritjen e tarifës së abonentit për thirrjet drejt rrjetit të Fix AMC dhe kjo natyrshëm pasi objektivi kryesor i Ligjit për Komunikimet Elektronike është përfitimi dhe mbrojtja e pajtimtarit.
 11. Ndërsa në lidhje me tarifën e terminimit në rrjetin AMC, AT duhet të theksojë se në këtë rast, ishte AT që kishte të drejtë të ngrinte këtë pretendim që në fillim pasi AMC kishte nënshkruar vërtet marrëveshjet e interkoneksionit me operatorët e tjerë por u ka ofruar të gjithëve tarife terminimi prej 1.54 lekë/min, ndërkohë që AT i ofroi tarifë prej 4.33 dhe 6.5 lekë/min. AMC në këtë rast ka vepruar dhe vazhdon në të njëjtin qëndrim plotësisht në kundërshtim me parimin e diskriminimit sipas të cilit nëse AMC i ofron një tarifë të ulët një palë është i detyruar t'ja ofrojë këtë tarifë edhe palëve të tjera të interesuara.
 12. AT ka qenë i vetëdijshëm për këtë element pavarësisht se AMC nuk është shpalluar OFNT në rrjetin e tij fix. Por, ashtu sic njihet ky parim edhe në dokumentet rregullatore

ndërkombëtare dhe ashtu sic është shprehur edhe vetë AKEP në Analizën e fundit të Tregut të telefonisë fikse cdo operator është me fuqi të ndjeshme në treg në rrjetin e tij të terminimit dhe në këtë këndvështrim AT kërkon që tarifat e Fix AMC të jenë nën rregullimin dhe objekt kontrolli i AKEP.

13. Albtelcom, sjell në vëmendje qëndrimin e AMC në takimin e mbajtur në AKEP se AMC nuk ka nevojë për investime shtesë për ofrimin e këtij shërbimi pasi mundëson ofrimin e shërbimit të Fix AMC nëpërmjet rrjetit ekzistues. Njëkohësisht sipas parimeve të konkurrencës, AMC nuk është aspak e lejuar që fuqinë dominante në një treg, ta mbartë në një treg tjetër nëpërmjet subvencionimit të tërthortë. AT ka plotësisht të drejtë të kërkojë nga AKEP vlerësimin e fuqisë së AMC në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin AMC fix, aftësinë e AMC për të transferuar fuqinë e ndjeshme nga një treg me shumicë në një treg tjetër me shumicë dhe po ashtu marrëdhëniet mes tregjeve përkatës. Në referencë me sa me sipër, varësisht natyrës së rrjetit të AMC dhe gjetjes së tarifës së përcaktuar nga AMC për terminimin e thirrjeve në AMC fix si në përputhje me kostot mbështetëse, atëherë edhe përcaktimin e tarifës së terminimit në rrjetin AMC për ofrimin e shërbimeve celulare tarifa e terminimit duhet të jetë në nivelin e terminimit në rrjetin AMC fix, pra 1.5 lekë/min.

- IV. AKEP pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e palëve gjykon se tarifat e terminimit në rrjetin fikse të Albtelcom janë në tre nivele lokal, njëfish dhe dyfish dhe aplikimi i secilit nivel tarife është në varësi të pikës apo pikave të interkoneksionit ku dorëzohet trafiku nga pala tjetër. Për të përfituar tarifë terminimi lokale për një zonë lokale, operatori tjetër (në këtë rast AMC) duhet të dorëzojë trafikun në pikën lokale përkatëse të interkoneksionit. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për pikat e tjera. Nëse i gjithë trafiku dorëzohet në pikë kombëtare atëherë operatori përfitues paguan tarife terminimi në segment dyfish për të gjitha thirrjet.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me VKD nr. 1730, datë 20.12.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Albtelcom sh.a.”

2. Të mos pranojë kërkesën e AMC për ndryshim të tarifave të terminimit të aplikuara midis AMC dhe Albtelecom për abonentët e AMC fix sipas marrëveshjes së interkoneksionit të nënshkruar nga të dy palët me Nr. 5334 Prot., Datë 24.10.2011 (referenca e AMC) dhe Nr.4084 Prot., Datë 9.09.2011 (referenca e Albtelecom).
3. Të njoftohen palët e interesuara Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Albtelecom sh.a.për mbylljen e procedimit administrativ.
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE